



**Zj. Jana Schuhmann**

Menaxhere e Fondit Sektorial,  
Fondi i Hapur Rajonal për Evropën  
Juglindore Reforma Ligjore,  
GIZ GmbH



Implemented by:  
**giz**  
German Development Cooperation

Perspektiva evropiane e rajonit i ka ndihmuar vendet të arrijnë reforma të përgjithshme politike dhe ekonomike me procese të përmirësuara demokratike. Në vitin 2016, tregtia totale e rajonit me BE-në ishte mbi 43 miliardë EUR, 80% më shumë se në vitin 2008 dhe me potencial të konsiderueshëm për t'u rritur. Kompanitë e BE-së janë, gjithashtu, investitorët më të mëdhenj në Ballkanin Perëndimor, me mbi 10 miliardë euro të Investimeve të Huaja Direkte në rajon vetëm në pesë vitet e fundit. Vendet e rajonit po veprojnë gjithnjë e më shumë si partnerë në skenën globale. Kjo perspektivë e vendosur dhe e bazuar në merita e anëtarësimit në BE për Ballkanin Perëndimor është në interesat e veta politike, të sigurisë dhe ekonomike të Bashkimit. Është një investim gjeostrategjik në një Evropë të qëndrueshme, të fortë dhe të bashkuar, bazuar mbi vlera të përbashkëta. Është një mjet i fuqishëm për të promovuar demokracinë, shtetin e së drejtës dhe respektimin e të drejtave themelore. Ekonomitë e rajonit përballen me shumë dobësi strukturore, me tregje joefikase dhe të ngurta, produktivitet të ulët, qasje të kufizuar në financa, të drejta të paqarta të pronës dhe një mjedis rregullator të rëndë, duke çuar në konkurrencë të ulët dhe papunësi të lartë. Në përgjithësi, nivelet e investimeve dhe ritmet e rritjes janë të pamjaftueshme për të zvogëluar ndjeshëm hendekun me BE-në. Zhvillimi ekonomik

pengohet më tej nga një ekonomi e ngulitur gri.<sup>1</sup>

Një investim në Ballkanin Perëndimor është një investim në Evropë. Investimet do të rriten vetëm nëse forcohet qeverisja ekonomike dhe ndiqen reformat strukturore për të rritur konkurrencën. Një përbërës i rëndësishëm i procesit të vendimmarrjes të investitorëve të ardhshëm është disponueshmëria e mjeteve juridike të parashikueshme dhe të besueshme për mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore dhe ekonomike. Arbitrazhi ndërkombëtar ka dëshmuar se është mekanizmi i preferuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për investitorët ndërkombëtarë në të gjithë botën, dhe rajoni i Ballkanit Perëndimor, në vitet e fundit, ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt krijimit të një sistemi modern të arbitrazhit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Të gjitha vendet e rajonit janë nënshkruese të Konventës për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj (Konventa e Nju Jork-ut) dhe të Konventës për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve midis Shteteve dhe Shtetasve të Shteteve të Tjera (Konventa ICSID).

Legjislati i tyre i arbitrazhit është në përputhje me Komisionin e Kombeve të Bashkuara për Ligjin Ndërkombëtar të Tregtisë (UNCITRAL), Ligjin Model për



Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar. Megjithëse ka shumë hapësirë për përmirësim, vendet e rajonit kanë treguar mirëkuptim dhe gatishmëri për të forcuar sistemin e arbitrazhit ndërkombëtar në juridiksionet përkatëse. Kohët e fundit, kjo u vërtetua me ratifikimin e Konventës së Singaporit për Ndërmjetësimin nga Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

Disa nga fushat kryesore që kanë nevojë për përmirësim dhe që janë identifikuar gjatë viteve janë mungesa e kapaciteteve të gjyqësorit për të mbështetur procedurat e arbitrazhit dhe potenciali për ndërhyrje të gjykatës në arbitrazh. Prandaj, ekziston nevoja për trajnim dhe edukim të gjerë dhe të vazhdueshëm për gjyqtarët dhe komunitetin juridik, në përgjithësi, për natyrën dhe menaxhimin e procedurave të arbitrazhit, si dhe për rolin e duhur të gjykatave. Përveç kësaj, ndryshe nga tradita e ngjashme ligjore e vendeve në rajon, ekzistojnë disa specifika të kornizës qeveritare në disa vende që kërkojnë vëmendje të veçantë dhe harmonizim të brendshëm.

Së fundmi, një sfidë tjetër është mungesa e vetëdijes së qytetarëve dhe disa praktikuesve ligjorë rreth arbitrazhit dhe disponueshmërisë së tij. Kjo mungesë familjariteti çon në mungesë besimi dhe ngurrim për t'i referuar mosmarrëveshjet në arbitrazh. Kjo mund të zgjidhet me një promovim të vazhdueshëm dhe objektiv, si dhe me rritje të vetëdijes. Kjo fushatë duhet t'i drejtohet kryesisht komunitetit të biznesit, si dhe popullatës së përgjithshme, në mënyrë që t'i prezantojë me disponueshmërinë dhe përfitimin e arbitrazhit si një mekanizëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Kjo duhet ta

rrisë frekuencën e referimeve në arbitrazh dhe një lehtësim të ngarkesave të gjyqësorit.

Gjatë viteve, ka pasur përpjekje të konsiderueshme të bashkësisë ndërkombëtare për angazhimin e rajonit në diskutimet ndërkombëtare të reformave në arbitrazhin ndërkombëtar, veçanërisht në fushën e Reformës së Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve Investitor-Shtet (ISDS). Masat më poshtë shërbejnë për ta mbështetur këtë qëllim dhe për të nxitur rritjen dhe krijimin e vendeve të punës, në veçanti, për të rinjtë e rajonit. Kuadri i Investimeve i Ballkanit Perëndimor i financuar nëpërmjet Instrumentit të Ndihmës së Para-Anëtarësimi do të jetë gjithnjë e më shumë në thelbin e nxitjes së investimeve në rajon. Për këtë qëllim, ai do të zgjerohet që të tërheqë dhe koordinojë më tej investimet e donatorëve dypalësh dhe të institucioneve ndërkombëtare të financimit.<sup>2</sup>

Që prej shumë vitesh tashmë, Fondi i Hapur Rajonal i GIZ-it për Evropën Juglindore - Reforma Ligjore, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), ka mbështetur institucionet në Ballkanin Perëndimor për të rritur kapacitetet e tyre për t'u marrë me procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, si dhe për të ndjekur dhe zbatuar zhvillimet më të fundit ndërkombëtare në rajon. Aktualisht ka diskutime si në nivelin ndërkombëtar ashtu edhe në kontekstin e BE-së se si duhen trajtuar traktatet për mbrojtjen e investimeve dhe si duhet të duken procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Këto diskutime po mbahen, ndër vendet e tjera, në grupe të ndryshme pune të



UNCITRAL-it siç është Grupi i Punës III:  
Reforma e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve  
Investitor-Shtet (ISDS).

Duke përdorur rrjetin rajonal dhe ndërkombëtar tashmë të krijuar, Fondi i Hapur Rajonal (ORF) synon të rrisë mësimin e ndërsjellë, ndarjen e praktikave dhe përvojave më të mira dhe bashkëpunimin në këtë fushë. Duke pasur parasysh që vendet e Ballkanit Perëndimor kanë rënë dakord për të zhvilluar një Zonë Ekonomike Rajonale dhe për t'i dhënë përparësi temës së investimeve, ORF-ja mbështet vendet për përfshirjen në diskutimet e vazhdueshme që zhvillohen në nivel ndërkombëtar dhe të BE-së. Për më tepër, projekti mbështet ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve kompetente në përgjigje të drejtpërdrejtë të nevojave të tyre. Duke i ofruar institucioneve mjetet e nevojshme dhe praktikën më të mira nga BE-ja dhe rajoni, është e mundur që rajoni të bëhet më tërheqës për investitorët dhe që investitorët të besojnë më shumë te sundimi i ligjit dhe korniza ligjore. Së fundmi, me njohuri dhe kapacitete të mjaftueshme, delegacionet rajonale duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në diskutimet ndërkombëtare për reformën e politikës së investimeve në baza të barabarta me aktorët e tjerë globalë.

*Mohim: Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë artikull janë vetëm deklarata personale të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pozicionin e ICC Albania. Përmbajtja e artikullit është vepra origjinale e autorit. Autori merr përgjegjësinë për çdo shkelje të autorësisë.*

*Versioni origjinal i artikullit është në gjuhën angleze*

-----  
<sup>1</sup> Strategjia e BE "Një perspektivë e besueshme e zgjerimit dhe angazhim të zgjeruar të BE me Ballkanin Perëndimor, [https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf)

<sup>2</sup> Strategjia e BE "Një perspektivë e besueshme e zgjerimit dhe angazhim të zgjeruar të BE me Ballkanin Perëndimor", [https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf)

